



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT  
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE  
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



# Investimet Kapitale të KRU-ve në Kosovë, Financuar nga Tarifat e Shërbimit të Ujit, për vitin 2023



## **Përmbajtja**

<b>1. Hyrje .....</b>	<b>3</b>
<b>2. Rëndësia e monitorimit të investimeve kapitale.....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>3. Metodologjia e punës për monitorimin e investimeve kapitale .....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>4. Takimet në KRU për monitorimin e listës së investimeve kapitale .....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>5. Investimet e aprovuara për KRU Hidroregjioni-Jugor .....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>6. Investimet e realizuara nga KRU-të sipas procesit të auditimit të të dhënave .....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>7. Monitorimi i listës së investimeve kapitale.....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>8. Konkluzione.....</b>	<b>11</b>
<b>9. Rekomandime .....</b>	<b>12</b>

## 1. Hyrje

Investimet e ofruesve të shërbimeve, nga burimet vetjake të financimit, në sektorin e shërbimeve me ujë dhe ujëra të ndotura, paraqesin një rëndësi të veçantë për Autoritetin dhe vetë sektorin.

Investimet kapitale janë të mbuluara me tarifën e shërbimeve të vitit 2023, të cilën e kanë paguar konsumatorët për shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura. Pjesa tjetër e investimeve materializohet në volumin e ‘Bazës Rregullatorë të Aseteve’, e cila në vijim, iu kthehet ofruesve të shërbimeve, përmes ‘Normës së kthimit në kapital’.

Prandaj, realizimi i këtyre investimeve është me rëndësi jetike, jo vetëm se konsumatorët i kanë paguar me tarifën e shërbimeve, por rëndësi ka edhe kjo ekuivalencë edhe për nivelin e ofruar të shërbimeve.

Departamenti i Tarifave, i prirë nga rëndësia e realizimit të këtyre investimeve, ka hartuar plan të veprimit, për monitorimin e realizimit të këtyre investimeve. Jo vetëm kaq - Departamenti i Tarifave, e ka monitoruar këtë realizim, projekt – për projekt, duke e fituar fotografinë reale të zhvillimit dhe ecurisë së këtyre projekteve.

Do theksuar se ofruesit e shërbimeve kanë realizuar më shumë investime, se sa është pasqyruar në këtë raport. Sipas ‘Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator’, investimet plasohen në librat kontabël, vetëm atëherë kur të jetë bërë pranimi teknik i projektit. Vetëm projektet e realizuara dhe të pranuar teknikisht, janë të përfshira në raportin tonë. Rrjedhimisht, investimet në vijim, të pa përfunduara dhe të pa pranuar teknikisht, rrisin ndjeshëm vlerën financiare të investimeve reale të ndodhura në terren. Realisht, KRU-të, gjatë vitit 2023, kanë investuar më shumë në projektet kapitale nga tarifat, se sa pasqyron raporti referues.

Investimet nga tarifat e shërbimit, shprehur në këtë raport, nuk janë indeksuar me normën e inflacionit. Sikur të bëhej ky indeksim inflacioni dhe të përfshiheshin ‘investimet në Vijim’, përqindja e realizimit të investimeve nga tarifat e shërbimit, do të ishin më të larta.

Mos realizimi i investimeve kapitale do të ketë ndikim në procesin e ardhshëm tarifor, sepse atëherë do të balancohen kundërvlerat e këtyre investimeve të paguara me tarifë dhe të pa realizuara.

Sidoqoftë, investimet kapitale nga tarifat, edhe pse shoqërohen me mangësi të theksuara, vizitat monitoruese në terren, dëshmuar se ofruesit e shërbimeve kanë përmirësuar cilësinë e planeve të biznesit, evidencat kontabël, janë rritur investimet dhe ka përparim edhe në strukturën e investimeve si dhe raportimi tek Autoriteti po avancojnë çdo vit.

## 2. Përmbledhje ekzekutive

Përgjatë vitit 2023, investime kapitale nga burimet e vetëfinancimit , të planifikuara gjithsej ishin 4,811,412.00€, kurse të realizuara 2,888,635.00€, ose 60%.

Për shërbimet e ujërave të ndotura, gjithsej investime kapitale vetjake, të planifikuara ishin 1,079,012.00€, kurse të realizuara 259,490.00€, ose vetëm 24 %.

Gjithsej investime vetjake nga ofruesit e shërbimeve, për ujë dhe UN, në vitin 2023, të planifikuara ishin 5,890,424.00 €, kurse të realizuara 3,148,125.00 €, ose 53.44 %.

- **KRU "Prishtina"**- Dështon përmbushja e caktit të investimeve kapitale, të përcaktuara gjatë procesit tarifor 2022-2024, për vitin 2023. Prej burimeve të financimit nga KRU, gjithsej ishin planifikuar 1,275,600€, prej të cilave u realizuan 701,477.00 €, apo shprehur në përqindje, vetëm 50 % të investimeve.
- **KRU "Mitrovica"** - Dështon përmbushja e caktit të investimeve kapitale, të përcaktuara gjatë procesit tarifor 2022-2024, për vitin 2023. Prej burimeve të financimit nga KRU, në total KRU-ja ka planifikuar 540,000.00 € prej të cilave ka realizuar 83,857.00 €, apo shprehur në përqindje, 15 % të investimeve.
- **KRU "Hidrodrini"** - Prej burimeve të financimit nga KRU, në total KRU-ja ka planifikuar 916,400.00 €, prej të cilave ka realizuar 521,631.00 €, apo shprehur në përqindje vetëm 57 % të investimeve.
- **KRU "Hidroregjioni Jugor"** - Gjatë procesit tarifor, për vitin 2023, KRU-ja kishte planifikuar investime në përtëritjen e infrastrukturës për shërbimet e ujësjellësit, por nuk i ka realizuar ato. Prej burimeve të financimit nga KRU, në total KRU-ja ka planifikuar 850,500.00 €, prej të cilave ka realizuar 495,307.00 €, apo shprehur në përqindje, vetëm 58 % .
- **KRU "Gjakova"** - Gjatë procesit tarifor,për vitin 2023, KRU-ja kishte planifikuar investime në përtëritjen e infrastrukturës për shërbimet e ujësjellësit, por nuk i ka realizuar ato, edhe pse janë në procedurë. Prej burimeve të financimit nga KRU, në total KRU-ja ka planifikuar 1,186,292.00 € prej të cilave ka realizuar 1,361,886.00 €, apo shprehur në përqindje ka realizuar vetëm 78 % të investimeve.
- **KRU "Bifurkacioni"**- Prej burimeve të financimit nga KRU, në total KRU-ja ka planifikuar 441,990.00 € prej të cilave ka realizuar 134,779.00€, apo shprehur në përqindje ka realizuar vetëm 30 % të investimeve.
- **KRU "Hidromorava"** - Gjatë procesit tarifor,për vitin 2023, KRU-ja kishte planifikuar investime në përtëritjen e infrastrukturës për shërbimet e ujësjellësit, por nuk i ka realizuar ato. Prej burimeve të financimit nga KRU, në total KRU-ja ka planifikuar 451,642.00 € prej të cilave ka realizuar 280,577.00 €, apo shprehur në përqindje ka realizuar vetëm 62.12 % të investimeve.

## Realizimi i caktit të investimeve shprehur në përqindje

Investimet kapitale nga burimet vetjake të financimit, për ujë, në vitin 2023, ishin gjithsej të planifikuara 4,811,412.00€.

Investimet kapitale nga burimet vetjake të financimit, për ujëra të ndotura, në vitin 2023, ishin gjithsej të planifikuara 1,079,012.00 €.

Përgjatë vitit 2023, investime kapitale nga burimet e vetëfinancimit, të planifikuara gjithsej ishin 4,811,412.00€, kurse të realizuara 2,888,635.00€, ose 60%.

Për shërbimet e ujërave të ndotura, gjithsej investime kapitale vetjake, të planifikuara ishin 1,079,012.00€, kurse të realizuara 259,490.00€, ose vetëm 24 %.

Gjithsej investime vetjake nga ofruesit e shërbimeve, për ujë dhe UN, në vitin 2023, të planifikuara ishin 5,890,424.00 €, kurse të realizuara 3,148,125.00 €, ose 53.44 %.

KRU “Hidromorava”, realizoi 280,577.00 €, ose 62 %;

KRU “Bifurkacioni”, realizoi 134,779.00€, ose 30 %;

KRU Gjakova’, realizoi 930,467.00€, ose 78 %;

KRU “ Mitrovica”, realizoi 83,857.00€ investime vetjake, ose 16%;

KRU “Hidrodrini”, investime vetjake të realizuara: 521,631.00€, ose 57%;

KRU “ Hidroregjioni Jugor”, gjithsej investoi 495,307.00 €, ose 58 %;

KRU “ Prishtina”, gjithsej investoi 701,477.00€, ose 47%.


### Investimet e planifikuara për vitin 2023

KRU	Uje	Ujera te ndotura	Totali
Prishtina	1,275,600	228,000	<b>1,503,600</b>
Hidroregjioni-Jugor	653,500	197,000	<b>850,500</b>
Hidrodrini	866,400	50,000	<b>916,400</b>
Mitrovica	390,000	150,000	<b>540,000</b>
Gjakova	978,392	207,900	<b>1,186,292</b>
Bifurkacioni	311,990	130,000	<b>441,990</b>
Hidromorava	335,530	116,112	<b>451,642</b>
<b>Sektor</b>	<b>4,811,412</b>	<b>1,079,012</b>	<b>5,890,424</b>


### Investimet e realizuara për vitin 2023

KRU	Uje	Ujera te ndotura	Totali	Realizimi
Prishtina	701,477	-	701,477	47%
Hidroregjioni-Jugor	493,986	1,321	495,307	58%
Hidrodrini	409,283	112,348	521,631	57%
Mitrovica	79,147	4,710	83,857	16%
Gjakova	915,233	15,264	930,497	78%
Bifurkacioni	118,601	16,178	134,779	30%
Hidromorava	170,908	109,669	280,577	62%
<b>Sektor</b>	<b>2,888,635</b>	<b>259,490</b>	<b>3,148,125</b>	<b>53%</b>

## Investimet e reaiuzara në vlerë monetare



## Përqindja e realizimit të investimeve



### 3. Planifikimi dhe realizimi i investimeve kapitale sipas kategorive

#### Shërbimet e ujësjellësit

Gjatë vitit 2023, gjithsej, nga 4,811,412.00 € investime të realizuara, për resurse dhe trajtim ishin 549,922.00 €. Ndërkaq, për infrastrukturë(përteritje dhe rritje) ishin gjithsej 80,460.00€, kurse për jo-infrastrukturë u realizuan gjithsej(Mirëmbajtje& rritje) 469,454.00 €. Në kosto qendrën – Distribuim(infrastrukturë dhe jo infrastrukturë), investime të realizuara gjithsej ishin 1,880,433.00 €.

Për aktivitete biznesore gjithsej ishin investuar 458,280.00 €, nga të cilat për mirëmbajtje ishin realizuar 101,488.00 €, ndërsa për rritje ishin investuar 356,792.00 €.

Struktura e investimeve, shprehur në përqindje është kjo: grumbullim- 19 %; aktivitete biznesore- 16.00 %,resurse dhe trajtim 65.00 %.

Struktura e investimeve vetjake në ujë, për infrastrukturë mbi tokësore dhe nën tokësore, është kjo : 38.00 % infrastrukturë dhe 62.00 % jo infrastrukturë.

Kategoria e investimeve kapitale			Vlera e planifikuar €		Vlera e realizuar €	
			Financuar nga KRU	Financuar nga Grantet	Financuar nga KRU	Financuar nga Grantet
Resurse dhe trajtim	Infrastrukturë	Përteritje	10,000	0	13,364	0
		Rritje	370,000	500,000	67,104	28,644
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	320,000	0	108,370	357,092
		Rritje	58,500	960,000	361,084	510,077
Distribuim	Infrastrukturë	Përteritje	2,000,298	8,358,000	<b>665,489</b>	734,709
		Rritje	232,000	5,300,000	<b>361,520</b>	3,204,137
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	793,414	0	<b>257,181</b>	137,381
		Rritje	284,400	0	<b>596,243</b>	380,729
Aktivitet Biznesor	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	539,300	0	101,488	0
		Rritje	203,500	130,000	356,792	0
<b>Totali</b>			<b>4,811,412</b>	<b>15,248,000</b>	<b>2,888,635</b>	<b>5,352,769</b>

## Shërbimet e ujërave të ndotura

Për shërbimet e ujërave të ndotura gjithsej investime të realizuara ishin 259,940.00 €, nga të cilat në grumbullim gjithsej u investuan 196,225.00 €; për trajtim të ujërave të ndotura, u investuan vetëm 4,467.00 €; për aktivitete biznesore 58,798.00 €.



U realizua kjo strukturë investimesh sipas kosto qendrave për shërbimet e ujërave të ndotura Për shërbimet e ujërave të ndotura gjithsej investime të realizuara ishin 259,940.00 €, nga të cilat në grumbullim gjithsej u investuan 196,225.00 €; për trajtim të ujërave të ndotura, u investuan vetëm 4,467.00 €; për aktivitete biznesore 58,798.00 €.

Struktura e investimeve, shprehur në përqindje është kjo: grumbullim- 75 %,trajtim të ujërave të ndotura -2.00 %; trajtim i llumit- 0.00 %;aktivitete biznesore- 23.00 %.



Struktura e investimeve vetjake për infrastrukturë mbi tokësore dhe nën tokësore, është kjo : 42.00 % infrastrukturë dhe 58.00 % jo infrastrukturë.

Kategoria e investimeve kapitale			Vlera e planifikuar €		Vlera e realizuar €	
			Financuar nga KRU	Grante	Financuar nga KRU	Grante
Grumbullim	Infrastrukturë	Përteritje	734,737	1,365,000	0	0
		Rritje	20,000	23,382,000	110,014	1,463,679
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	137,375	0	25	0
		Rritje	0	0	86,186	0
Trajtim ujërave ndotura	Infrastrukturë	Përteritje	0	0	0	0
		Rritje	0	36,750,000	0	6,323,785
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	0	0	0	0
		Rritje	0	0	4,467	9,868,618
Trajtim i llumit	Infrastrukturë	Përteritje	0	0	0	0
		Rritje	0	0	0	0
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	0	0	0	0
		Rritje	0	0	0	0
Aktivitet Biznesor	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	90,400	550,000	6,421	0
		Rritje	96,500	550,000	52,377	0
<b>Totali</b>			<b>1,079,012</b>	<b>62,597,000</b>	<b>259,490</b>	<b>17,656,082</b>

## Investimet kapitale sipas kosto qendrave



## Investimet infrastrukturore (mbitokësore & nëntokësore)



## 4. Konkluzione

1. Ngec përmbushja e cakut të investimeve kapitale në sektor, të përcaktuara gjatë procesit tarifor 2022-2024, për vitin 2023,
2. Përgjatë vitit 2023, investime kapitale nga burimet e vetëfinancimit për ujë, të planifikuara gjithsej ishin 4,811,412.00€, kurse të realizuara 2,888,635.00€, ose 60%.
3. Për shërbimet e ujërave të ndotura, gjithsej investime kapitale vetjake, të planifikuara ishin 1,079,012.00€, kurse të realizuara 259,490.00€, ose vetëm 24 %.
4. Gjithsej investime vetjake nga ofruesit e shërbimeve, për ujë dhe UN, në vitin 2023, të planifikuara ishin 5,890,424.00 €, kurse të realizuara 3,148,125.00 €, ose 53.44 %.
5. Prej burimeve të financimit nga grantet, sektori, ka planifikuar 77,845,000.00 €, kurse ka realizuar 23,008,851 .00 €, ose, është 63.3%.
6. Ofruesit e shërbimeve nuk arritën për ta sjellë në ARRU azhurnimin e 'Listës së investimeve kapitale nga burimet vetjake të financimit', pas ndërhyrjeve rregulluese nga Departamenti i Tarifave,
7. Investimet në përtëritjen e infrastrukturës për shërbimet e ujit, ofruesit e shërbimeve, nuk i kanë realizuar sipas planifikimeve. Kjo kategori e investimeve ka shumë rëndësi në nivelin e shërbimit, njëherësh ka ndikim direkt edhe në tarifa.
8. Në kategorinë e investimeve - infrastrukturë e ujërave të ndotura, me mjetet vetjake të financimit, KRU-të nuk kanë bërë investime sipas planifikimeve.
9. Mos realizimi i investimeve kapitale ishte ndikuar nga vonesat në procedurat e prokurimit, kërkesave nga donatorët për ndërhyrje emergjente, problemet financiare, nga keq menaxhimi etj.
10. Disa projekte janë në vijim, ka edhe të atilla që janë kryer, por akoma nuk është bërë pranimi teknik, duke rezultuar në mos regjistrim në kontabilitet, referuar 'Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator'.
11. Ka mangësi tek kontimi i shpenzimeve të ujërave të ndotura, rezultuar si shpenzime - jo reflektuese.
12. Mungon mbështetja e plotë në Planin e Menaxhimit të Aseteve(PMA), duke rezultuar me planifikim jo të mirë sipas prioriteteve të projekteve të investimeve kapitale, njëherësh, edhe arsyetimi i projekteve ka pasur mangësi.
13. Ofruesit e shërbimeve, akoma nuk arritën për të bërë Planifikim të Investimeve Afatgjata(PIA), përjashtimisht dy kompanive. Po ashtu edhe kjo e ka kufizuar burimin për një plan të mirë biznesi.
14. Ofruesit e shërbimeve nuk arritën që ta sjellin Plan Biznesi të njëjtë në ARRU, sikurse në NPMNP.
15. Ofruesit e shërbimeve, nuk ia dolën, që të kërkojnë nga ARRU aprovimin e ndryshimeve në projektet e aprovuara me BPRR.
16. Në tërësi, vërehet një përmirësim domethënës tek sektori, si në sasi e po ashtu edhe në cilësinë e investimeve, shprehur edhe në kategorizim të investimeve.
17. ARRU, në këtë raport, nuk ka kalkuluar edhe 'Investimet në Vijim, si dhe indeksimin për normën e inflacionit, duke rezultuar, në dukje, me më pak investime nga tarifa e shërbimit.
18. Për gjithë këto mangësi, ARRU ka ngritur shqetësimin e vet tek menaxhmenti i KRU-ve, tek bordet e tyre dhe tek aksionari, duke pritur reflektim.

## • Rekomandime

1. Ofruesit e shërbimeve duhet që ta njëjtësojnë Planin e Biznesit të ARRU-së me atë të NPMNP-së
2. Ofruesit e shërbimeve duhet ta braktisin praktikën e mos dorëzimit në ARRU 'Listën e azhurnuar të Investimeve kapitale', pas ndërhyrjeve rregullatore.
3. Ofruesit e shërbimeve duhet që ta përmirësojnë cilësinë e Plan Biznesit, duke u mbështetur në Planin e Menaxhimit të Aseteve dhe PIA;
4. Për investimet e pa realizuara kapitale, gjatë viteve vijuese, në procesin e ardhshëm tarifor 2026-2028, ARRU do të ndërmerr veprime rregulluese sipas Rregullores Nr.12/2020 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë.
5. Rekomandojmë që KRU-të të jenë të vëmendshme që për shkak të procedurave të prokurimit, problemeve financiare, ndërrimeve të fundit të menaxhmentit, që të angazhohet, që këto të mos ndikojnë në mos realizimin e investimeve kapitale.
6. Rekomandojmë KRU-të që të angazhohen më shumë në finalizimin e Planit të Menaxhimit të Aseteve, i cili pasqyron gjendjen reale të asetëve të kompanive.
7. Rekomandojmë KRU-të që të kenë koordinim më të mirë me komunën dhe donatorët e tjerë në mënyrë që planifikimet të bëhen me kohë dhe sipas prioriteteve dhe të përfshihen saktë në aplikacionin tarifor.
8. Rekomandojmë KRU-të, që të bëjnë planifikim të saktë sipas nevojave prioritare, që shpijnë kah efienca më e mirë dhe zvogëlimi i humbjeve të ujit
9. Rekomandojmë ofruesit e shërbimeve, që të jenë të vëmendshëm që, investimet në përtëritjen e infrastrukturës për shërbimet e ujit, t'i realizojnë sipas planifikimeve. Kjo kategori e investimeve, për ARRU, ka shumë rëndësi në nivelin e shërbimit, njëherësh ka ndikim direkt edhe në tarifa. Praktika e deritanishme nuk do të tolerohet nga Autoriteti.
10. Rekomandojmë ofruesit e shërbimeve që ta hartojnë 'Planin e Investimeve Afatgjata', sa më parë që është e mundur.
11. Rekomandojmë ofruesit e shërbimeve që, të mos bëjnë asnjë ndryshim të projekteve nga BPRR, pa aprovimin e Autoritetit.
12. Rekomandojmë ofruesit e shërbimeve që t'i evitojnë këto mangësi, sepse Autoriteti do t'i ndërmerr veprimet, që kanë kundërvlerë të impaktit në tarifa, nivelin e shërbimeve, dhe veprime të tjera ligjore ,etj.

*Ky raport u punua nga:  
Departamenti i Tarifave të ARRU*